



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

**K.Dh.Sh.II.nr.1151/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**– Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Pro Credit Bank Sh.a me seli ne Prishtinë, kundër debitorëve: 1. “Suti As” NT me seli në rrugën Nëna Terez nr.16 në Fushë Kosovë, 2. F.K. me vendbanim në rrugën Mazllom Lakuci nr.66 në Gjakovë dhe 3.B.K. me vendbanim në rrugën Mazllom Lakuci nr.66 në Gjakovë, objekt përmbartimi pagesën e kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.138/22 të datës 22.06.2023, me datën 19.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Pro Credit Bank Sh.a me seli ne Prishtinë, dhe aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 138/22 të datës 22.06.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 138/22 të datës 22.06.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Suti As” NT, F.K. dhe B.K. me vendbanim në Gjakovë, anulohet urdhëri përmbartimor P.nr.279/2018 i datës 23.07.2018 i përmbartuesit privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë, si dhe përfundohet procedura përmbartimore në këtë çështje. Ndërsa në dispozitivin e dytë ka refuzuar si të pa bazuar ankesat kundër parregullsive me rastin e kryerjes së përmbartimit të ushtruar nga debitorët e përmbartimit “Suti As” NT, F.K. dhe B.K. me vendbanim në Gjakovë kundër urdhërit përmbartimor P.nr.279/2018 i datës 23.07.2018 i përmbartuesit privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë kanë parashtruar debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përbarimore, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i ankimuar.

Debitori ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e debitorit dhe aktvendimi i ankimuar të vërtetohet si e bazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Zyra Përbarimore e përbaruesit privat Ajet Mjeku me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përbarimor me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të Kontratën mbi Kredinë për Biznes Nr. FË1022, amendamenti nr.2 për Kontratën e Kredisë për Biznes i datës 27.02.2017 derivuar për ristrukturimit të kontratës së kredisë për biznes nr.89005582, si dhe amendamenti nr.1 i Kontratës së Kredisë për Biznes, amendamenti nr.1 për Kontratën e kredisë për biznes i datës 27.02.2017 derivuar pas ristrukturimit të kontratës së kredis për biznes nr.89007492 i datës 24.06.2015 dhe kontratës së kredisë për biznes nr.89009484 dt.27.02.2017 mbi borxhin total prej 175,658.51euro.

Kundër propozimit për përbarimin, prapsim ka paraqitur debitori në afat të rregullt ligjor, me të cilin ka theksuar se debitori me anë të këtij prapësimi në tërësi e kundërshton urdhrin e përbaruesit privat (me pretendime si në prapësim) duke shtuar se marrëveshja mbi hipotekën dhe marrëveshja mbi pengun nuk janë dorëzuar në origjinal dhe në kopje të vërtetuar dhe se nuk janë titull ekzekutiv siç kërkohet me nenin 38 par.1 të LPP-së, dhe se titulli nuk është dorëzuar fare ashtu siç kërkohet me ligj.

Kreditori nuk ka paraqitë përgjigje në prapësim.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit dhe përgjigje në prapësim të kreditorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar, me arsyetim se kreditori të gjitha dokumentet, duke përfshirë kontratën për pengun dhe kontrata për kredinë në bazë të cilat është paraparë që kërkesat të sigurohen me hipotekë dhe amendamenti e këtyre kontratave lidhur në formë të shkruar të përgaditur prapakisht nga kreditori dhe pa pjesëmarrjen e noterit, si dhe janë dorëzuar në kopje të vulosur vetëm nga kreditori pra jo nga noteri ashtu si pas nenit 22 para 1 nënparagrafin 1.7 dhe 1.7 a të LPP-së, andaj dhe nuk i plotësojnë kushtet për të qenë tituj përmbarrimor. Po ashtu ka cek se sa i përket ankesës së debitorëve kundër parregullsisve me rastin e kryerjes se përmbarrimit të ushtruar gjykata vëren se ajo ka të bëjë me vetë nxjerrjen e urdhërit përmbarrimor për lejimin e përmbarrimit përmes shitjes së ngastrës kadastrale 1817-17 në zonën kadastrale në Prishtinë, nxjerrja e urdhërit përmbarrimor nuk paraqet veprim përmbarrues kundër të cilit mund të paraqitet kjo ankesë. Ky mjet juridik mund të paraqitet kundër veprimeve procedurale që i ndërmerr përmbarruesi me qëllim të realizimit të së drejtës që kërkohet të ekzekutohet, kur vlerëson se ato janë ndërmarrë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Ka shtuar se gjykata e sheh të asyeshme të sqaroj se edhe pse vendosja si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi praktikisht është jo lëndore me që urdhëri përmbarrimor është anuluar dhe procedura përmbarrimore është përfunduar, megjithatë ankesa e debitorit paraqet mjet juridik sipas të cilit gjykata ka për obligim të vendos përderisa nuk është tërhequr.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se urdhri për lejimin e përmbarrimit të përmbarruesit privat bazohet në dokumente si që janë kontratat për pengun, kontrata për kredinë në bazë të cilave është paraparë që kërkesat të sigurohen me hipotekë, dhe amendamentet e këtyre kontratave të lidhur në formë të shkruar të përgaditura në kopje të vulosura vetëm nga kreditori dhe të cilat nuk janë të vërtetuara tek noteri. Andaj, edhe kjo gjykatë

vlerëson se në rastin konkret propozimi i kreditorit për përmbarrim nuk përmbanë titull përmbarrimor sepse kreditori të gjitha dokumentet, duke përfshirë Kontratën mbi Kredinë për Biznes Nr. FË1022, amendamenti nr.2 për Kontratën e Kredisë për Biznes i datës 27.02.2017 derivuar për ristrukturimit të kontratës së kredisë për biznes nr.89005582, si dhe amendamenti nr.1 i Kontratës së Kredisë për Biznes, amendamenti nr.1 për Kontratën e Kredisë për biznes i datës 27.02.2017 derivuar pas ristrukturimit të kontratës së kredisë për biznes nr.89007492 i datës 24.06.2015 dhe Kontratës së Kredisë për biznes nr.89009484 dt.27.02.2017, janë dorëzuar në kopje, por të vulosura vetëm nga kreditori, ngase edhe sipas nenin 36 i LPP-së është paraparë se “ *Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrushmërisë për përmbarrushmëri* ” pra, sipas kësaj dispozite kërkohet që kopja të jetë e vërtetuar sipas ligjit. Mirëpo me kruciale është se rregjistrimi i pengun të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nuk është dorëzuar. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se sipas nenit 22 pika 1.7a i Përndryshimin dhe plotësimin Ligjit të Procedurën Përmbarrimore Ligji 05/L-118, kërkohet që marrëveshja për pengun vetëm forma e shkruar dhe rregjistrimi i pengut në regjistrin publik, ndërsa kreditori e nuk e ka dorëzuar konfirmimin e regjistrimit e pengut.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të ankimuar, mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit sa i përket asaj se vërtetimi për regjistrimin e pengut gjindet në lëndë një pretendim të till kjo gjykatë e refuzoj si të pa bazuar sepse askund në shkresa të lëndës nuk figuron se kreditor ka dorëzuar ndonjë provë me të cilën do ta vërtetonte se sendet e lëna peng kanë qenë të regjistruar në zyrën përkatëse në momentin e dorëzimit të propozimit. Po ashtu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore por i refuzoj si të pa bazuar për shkak se nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarrimore.

Dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave në lëndë vlerëson se kreditori nuk ka ushtruar propozim për përmbarrim konform dispozitave ligjore. Andaj, kjo gjykatë e pranon si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për shfuqizimin e urdhrit përmbarrimor me të cilin është lejuar përmbarrimi sipas propozimit të kreditorit i cili sipas kësaj gjykate nuk i plotëson kushtet ligjore për tu përmbarruar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë**

K.Dh.Sh.II.nr.1151/23, me datë 19.04.2024

Gjyqtarja

Franciska Zhitija Ymeri